



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
DREJTORIA JURIDIKE  
NJËSIA E PROKURIMIT

**PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – E hapur e thjeshtuar- Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE  
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Supervizim i "Ndertimit te Qendres Operacionale te Emergjencave Civile"

**Kodi CPV:** 79714000-2 - Shërbime të mbikqyrjes

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 3,476,348.<sup>6</sup> (tremilion e katerqind e shtatedhete e gjashtemije e treqind e dyzete e tete presje gjashte) lekë pa t.v.sh.

**REF-91662-06-29-2026**

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ka hartuar kriteret e mëposhtme të kualifikimit dhe specifikimet teknike për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt shërbimi mbikqyrje.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “*Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë*

*paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

### ***Argumentim:***

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43 pika 2 germa “c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për xhiron minimale është vendosur në funksion të verifikimit të kapaciteteve ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Vlera e kërkuar është përcaktuar në mënyrë proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk tejkalon kufijtë e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

**2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivit. (Në raste se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me aktekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

### ***Argumentim:***

Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 77 pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur në funksion të verifikimit të gjendjes financiare dhe qëndrueshmërisë ekonomike të operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procedurë.

Dokumentacioni i kërkuar i shërben Autoritetit Kontraktor për të vlerësuar aftësinë financiare të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

**2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për keestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

### ***Argumentim:***

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 43 pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e vërtetimit të shlyerjes së taksave vendore është vendosur në funksion të verifikimit të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe fiskale nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Dokumentacioni i kërkuar i shërben Autoritetit Kontraktor për të garantuar që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin fiskal dhe administrativ në fuqi.

### 3. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojë të mëparshme të ngjashme në shërbime projektimi për akse rrugore urbane, rrugë të reja , rikualifikim urban ose infrastrukturë transporti.

- a) Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**".

#### *Argumentim:*

Kriteri është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenin 41 të VKM nr.285/2021, në funksion të verifikimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik për realizimin e kontratave të ngjashme të projektimit.

### 3.2 Licencat profesionale

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrje punimesh zbatimi në ndërtim të lëshuar nga autoritetet kompetente, ku të përfshihen kategoritë:

- NP-1 Punime gërmimi në tokë
- NP-2 Ndërtime civile dhe industrial
- NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre
- NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- NS-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, Tv

Në rastet e operatorëve të huaj do të bëhet njehsimi i licencave sipas legjislacionit shqiptar.

### ***Argumentim:***

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41 pika 4 germa “a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016.

#### **NP-1 – Punime gjurmimi në tokë**

Nevojitet nëse projekti përfshin gjurmime për themele, bodrum, rezervuarë uji, kanale për rrjete teknologjike ose sisteme të terrenit. Pa punime gjurmimi nuk mund të realizohen themelet e objektit.

#### **NP-2 – Ndërtime civile dhe industriale**

Është kategoria bazë për ndërtimin e godinës. Përfshin punimet e betonit, muraturës, konstruksioneve, çatisë dhe të gjitha punimet civile të objektit. Kjo është licenca kryesore për realizimin e ndërtesës.

#### **NS-2 – Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre**

Justifikohet sepse objekti duhet të ketë rrjet furnizimi me ujë, kanalizime, pajisje sanitare dhe, nëse parashikohet, sisteme hidrantesh ose rrjete kundër zjarrit me ujë.

#### **NS-12 – Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit**

Një qendër operationale duhet të funksionojë 24/7, ndaj zakonisht kërkon sisteme HVAC (ngrohje, ventilim dhe kondicionim), ventilim të dhomave teknike dhe ambienteve ku ndodhen serverët apo pajisjet elektronike. Kjo kategori mbulon këto instalime.

#### **NS-14 – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV**

Është një nga kategoritë më të rëndësishme për këtë objekt, pasi qendra duhet të ketë instalime elektrike, rrjete komunikimi, telefoni, internet, sisteme alarmi, kamera sigurie dhe infrastrukturë për radiokomunikim.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale të nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Kategoritë e kërkuara të licencës lidhen drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i

cili konsiston nën hartimin e projektit për ndërtimin e një aksi të ri rrugor urban lidhës dhe riorganizimin e skemës së qarkullimit urban ndërmjet rrygëve ekzistuese, duke përfshirë projektimin rrugor, rilevimet inxhinierike, studimet gjeologo – inxhinierike, projektimin e drenazhimit dhe kanalizimeve rrugore, projektimin e ndriçimit publik si dhe projektimin e sinjalistikës rrugore . Licencat e kërkuara janë përcaktuar në mënyrë proporcionale dhe në funksion të realizimit korrekt të shërbimeve të mbikqyrjes që do të kryhen në kuadër të kësaj procedure prokurimi.

#### **4. Kapaciteti teknik**

**4.1** Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik dhe të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar minimalisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Drejtues teknik)
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Për stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme);
- Diplomat përkatëse;
- Licencat profesionale sipas profilit;
- Listpagesën e muajit të fundit të deklaruar

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

#### **Argumentim:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41 pika 4 germa “b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- **1 Inxhinier Ndërtimi (Drejtues teknik)** – është i domosdoshëm për drejtimin teknik të punimeve, zbatimin e projektit, kontrollin e cilësisë dhe respektimin e legjislacionit të ndërtimit.
- **1 Arkitekt** – nevojitet për zbatimin korrekt të projektit arkitektonik, koordinimin e ndryshimeve eventuale gjatë punimeve, përfundimet arkitektonike dhe përputhshmërinë me projektin e miratuar.
- **1 Inxhinier Hidroteknik** – justifikohet nëse objekti përfshin rrjetet e furnizimit me ujë, kanalizimet, drenazhimin e ujërave atmosferike, rezervuarët, sistemet kundër zjarrit me ujë ose punime të tjera hidroteknike.
- **1 Inxhinier Elektrik** – është thelbësor për instalimet elektrike, ndriçimin, sistemet UPS, gjeneratorët, rrjetet e komunikimit, sistemet e alarmit dhe pajisjet kritike që një qendër emergjencash duhet të ketë.
- **1 Inxhinier Mekanik** – nevojitet për sistemet HVAC (ngrohje, ventilim dhe kondicionim), sistemet mekanike kundër zjarrit, ventilimin e ambienteve teknike dhe instalimet e tjera mekanike.

Profesionet e kërkuara janë përcaktuar në përputhje me detyrën e projektimit dhe shërbimet që do të realizohen në kuadër të kësaj procedure prokurimi duke përfshirë projektimin rrugor, rilevimet topografike, projektimin e drenazhimit dhe kanalizimeve rrugore, studimet gjeologjike – inxhinierike, projektimin e ndriçimit publik dhe sinjalistikës rrugore. Prania e stafit teknik të kërkuar shërben për të garantuar realizimin me cilësi dhe në përputhje me standartet teknike të projektit objekt prokurimi.

**4.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 6(gjashtë) punonjës të siguruar për muajin e fundit të deklaruar.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit të deklaruar;
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse.

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentim:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr.162, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41 pika 4 germa “c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Numri i kërkuar i punonjësve është vendosur në mënyrë proporcionale me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe në funksion të realizimit me sukses të shërbimeve objekt prokurimi.

**4.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizma ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Certifikatë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të cilësisë, të vlefshme.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO sipas pjesës së shërbimit që merr përsipër të realizojë.)

### ***Argumentim:***

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Certifikimi ISO 9001:2015 është kërkuar në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimeve të projektimit dhe organizimit teknik të operatorit ekonomik që do të realizojë kontratën.

Kjo certifikatë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e standardeve të menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**4.4** Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

Argumentimi: Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

## **II Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike dhe dokumentacioni i nevojshëm janë hartuar në përputhje me natyrën e objektit të kontratës, kërkesat e detyrës së projektimit dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor.

Në hartimin e specifikimeve teknike nuk është përdorur asnjë markë, origjinë, patentë apo referencë specifike që favorizon ose diskriminon operatorë ekonomikë të caktuar, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë proporcionale dhe në funksion të realizimit korrekt të shërbimeve të projektimit objekt prokurimi.